



Pranuar / Dorezuar Punëhënë/Prodato Received/Delivery	05.12.2023	3	viti god year
Organ /Bjësia Organ /Jedinstva Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prof No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRGJKUK	7237/2023		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1248/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Çabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj Demianëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1248/2023 të datës 05.10.2023 të ankuesi kundër Vendimit KA.nr.33/2023 të datës 29.09.2023 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKGJK-së, në çështjen juridike “shkelje e të drejtës në pagë”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 04.12.2023, mori:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.1248/2023 e datës 05.10.2023 e parashtruar nga ankuesi**
- II. Mbetet në fuqi Vendimi KA.nr.33/2023 i datës 29.09.2023 i Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.**

A r s y e t i m

Ankuesi Kreshnik Kënduesi, i cila sipas shkresave të lëndës është i punësuar në Gjykatën Themelore në Gjakovë, me datë 05.10.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar Këshilli) e cila është regjistruar dhe protokolluar me numër 6398/2023, kundër Vendimit KA.nr.33/2023 të datës 29.09.2023 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKGJK-së.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave, me rastin e refuzimit të ankesës së ankuesit, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e

ligjit material dhe deri tek nxjerrja e Vendimit KA.nr.33/2023 të datës 29.09.2023 ka ardhur për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, me kërkesën që Këshilli të anuloi aktin e kontestuar dhe të obligojë SKGJK-në korrigjojë aktin e emërimit të tij ashtu që ankuesi të kategorizohet në: "Paga: Grupi J, klasa J14, Koeficienti 8" apo "Paga: Grupi J, klasa J14, Koeficienti 7.5", me arsyetimin se konkursi i shpallur paraprakisht gjatë vitit 2022 lidhur me pozitën "Mbikëqyrës i Sektorit për Ekzekutim, Arkivim dhe Statistika" ka qenë i përcaktuar se pozita në fjale është nivelit e drejtues, me pretendimin se konkursi i rishpallur në vitin 2023 ka qenë vazhdimësi e konkursit paraprak dhe se i njëjti nuk ka qenë i njohur se pozita do të karakterizohet sipas aktit të emërimit: "Paga: Profesional 1, klasa J15, Koeficienti 5.85" kurse këtë informatë e ka kuptuar me rastin e nënshkrimit të aktit të emërimit ku më pastaj ka hapur procedurë ankimor pranë institucionit punëdhënës.

Këshilli bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datën 11.10.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të SKGJK, ndërsa me datë 02.11.2023, ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Sipas kërkesës së Kryetarit të Kolegjit, me datë 16.11.2023 Kryetari i Këshillit ka nxjerr Vendim VK/2023 me numër protokolli 7021/2023 përmes të cilit ankesës së ankuesit A.nr.1248/2023 ia ka vazhduar afatin vendimmarrës edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën e datës 05.10.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Vendimin KA.nr.33/2023 të datës 29.09.2023 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Akt emërimit e datës 01.09.2023; Konkursin e brendshëm me shifër Nr.02/2022; Rregulloren 7/2021 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të Punës në Gjykatën Themelore dhe Degët e Tyre; Strukturën organizative të Gjykatës Themelore në Gjakovë; Katalogun i pozitave dhe përshkrimit të vendeve të punës për të punësuarit e gjyqësorit i datës 17.05.2023; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Mbikëqyrës i Sektorit për Ekzekutim, Arkivim dhe Statistika; Vendimin e Këshillit A.nr.917/2023 të datës 17.08.2023; Zarfën postar me shifër R5403856; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 11.10.2023; Përgjigjen e datës 02.11.2023; Vendimin KA.nr.04/2023 të datës 16.02.2023 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Fletë kthesë; Ankesën e datës 17.01.2023; Vendimin e datës 18.01.2023; Konkursi i brendshëm i datës 02.03.2023 me shifër nr.01/2023; Listën e pagave të ankuesit për muajin tetor 2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjitha shkresave të bashkangjitura të lëndës të dërguara nga palët në procedurë konstatoi se ankesa e ankuesit Kreshnik Kënduesi, është e pabazuar sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se Këshilli Gjyqësor i Kosovës sipas konkursit të datës 02.03.2023 me shifër Nr.01/2023 ka shpallur konkursin e brendshëm për pozitën "Mbikëqyrës i Sektorit për Ekzekutim, Arkivim dhe Statistika", në të cilin konkurs ka rezultuar kandidat i suksesshëm ankuesi, dhe të njëjti me datë 01.09.2023 i është lëshuar akti i emërimit. Po ashtu nga analizimi i përmbajtjes së konkursit të datës 02.03.2023 është konstatuar se lidhur me pozitën në të cilën ankuesi ka rezultuar të jetë kandidatë i suksesshëm kanë qenë të përcaktuara edhe veçoritë e pozitës qysh me rastin e publikimit të konkursit, respektivisht ka qenë e përcaktuar pozita "Mbikëqyrës i Sektorit për Ekzekutim, Arkivim dhe Statistika" lidhur me gradën e vendit të punës përcaktohet si në vijim: "Kategoria Profesionale-Profesional 1; "Grupi J- klasa J15,

Koeficienti 5.85".

Kolegji i Këshillit pas analizimit të pretendimeve ankimore të ankuesit dhe shkresave të lëndës ka ardhur në përfundimin se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimi KA.nr.33/2023 i datës 29.09.2023 përmes të cilit ankuesit ia ka refuzuar ankesën e datës 26.09.2023 lidhur me klasifikimin e pozitës së punës sipas aktit të emërimit të datës 01.09.2023, kanë vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e nenit 86 paragrafi 1 dhe nenit 88 paragrafi të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe dispozitave të Rregullores nr.05./2011 për Procedurat e Zgjedhjes se Kontesteve dhe Ankesave, ngase akt i emërimit të datës 01.09.2023 përmes të cilit ankuesi është emëruar në pozitën *"Mbikëqyrës i Sektorit për Ekzekutim, Arkivim dhe Statistika"* përcakton në mënyrë të njëjtë gradën apo kategorinë e pozitës *"Kategoria Profesionale-Profesional 1; "Grupi J- klasa J15, Koeficienti 5.85"* sikurse ishte përcaktuar edhe me rastin e shpalljes së konkursit me datë 02.03.2023 dhe shifër Nr.01/2023, dhe mbi këtë bazë ankuesi me rastin e aplikimit apo dorëzimit në këtë konkurs sikurse përcaktohet me nenin 21 dhe 22 të Rregullore Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimi në Shërbimin Civil në fakt edhe i ka pranuar kushtet dhe kriteret e punës të përcaktuar në konkurs.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit për pritshmëritë e ligjshme të cilave iu referohet duke specifikuar konkursin e datës 13.06.2022 dhe përcaktimeve të këtij konkursi lidhur me gradën e pozitës *"Mbikëqyrës i Sektorit për Ekzekutim, Arkivim dhe Statistika"*, me arsyetimin se konkursi i rishpallur sipas konkursit të datës 02.03.2023 është vazhdimësi e statusit, të drejtave dhe përgjegjësi të parapara edhe në konkursin paraprak, Kolegji i Këshillit thekson faktin se një pretendim i tillë nuk gjen mbështetje në nenin 8 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative sikurse përcaktohet se: *"Veprimet e organeve publike duhet të jenë të parashikueshme dhe të respektojnë pritshmëritë legjitime dhe të arsyeshme të personave."*, pasi që konkuret në fjalë janë dy procese të ndara, respektivisht ankuesi pritshmëritë e ligjshme mundet me i ndërlihd vetëm duke iu referuar konkursit të datës 02.03.2023 ngase në këtë procedurë të rekrutimit ka rezultuar i suksesshëm dhe se me rastin e aplikimit i njëjti i ka pranuar kushtet dhe kriteret e pozitës të cilat janë të njëjta sikurse ato të përcaktuara në aktin e emërimit të datës 01.09.2023 lidhur me gradën, kategorinë profesionale, grupin-klasën dhe koeficientin.

Kolegji i Këshillit po ashtu, nisur nga të gjeturat e dhëna si më lartë ka konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit KA.nr.33/2023 të datës 29.09.2023, ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr.5/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, ngase ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, dhe se akti i kontestuar ka mbetur në fuqi, ndërsa pretendimet ankimore të ankuesit nuk gjejnë mbështetje në ligj dhe ankesa e tij e datës 05.10.2023 është refuzuar si e papabazuar sikurse në dispozitivin e këtij vendimi.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1248/2023

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

